



KONTRATA

Komuna e Prishtines, Adresa e AK: TREPQES NR.2, Qyteti: Prishtine, Kodi Postar: 10000 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

Dhe

EKOVIZION “EV”, me adresë: Rr. “Zahir Pajaziti” p.n. Podujevë, me nr. të regjistrimit: 5110005-9, me nr.fiskal: 600346713, me drejtë: Shpend Sopa (ne vazhdim “Konsulenti”), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

Mbështetja teknike për hartimin e planit të menaxhimit të Parkut Gërmia me numër identifikues:

Nr. i prokurimit ¹	616-19-1864-3-2-2
Nr i brendshëm	616 19 019 322

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Konsulentit:
Mbështetja teknike për hartimin e planit të menaxhimit të Parkut Gërmia

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve konsulente duhet të jetë: **24.970,00 €; [Njëzet e katërmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë euro].**

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vëtmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka boryh Konsulentit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kjo Marrëveshje e Kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Konsulentit, (Propozimin Teknik dhe Financiarë);
- Propozimi financiarë;
- Apendikset në vijim:
 - Apendiksi A: Përshtimi i Shërbimeve;
 - Apendiksi B: Kërkesat e Raportimit
 - Apendiksi C: Peroneli kryesorë dhe nën kontraktuesit
 - Apendiksi D: Shërbimet dhe hapësirat e ofruara nga Autoriteti Kontraktues
 - Apendiksi E: Formulari i Garancisë Bankare për Pagesë të Avancuar.
- [Ishëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

¹ Da se izveštava u svakom dokumentu ili zahtevu u vezi sa aktivnost nabavke.

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Konsulenti nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj "ose"vendosë "do të interpretohen në përputhje me rr Ethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën **shqipe** në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Konsulentin.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	<i>PP. ZEKE BARAJAT NEZHNU MOKAÇU'</i>
Pozita:	Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit
Nënshkrimi:	<i>N.M.lliuni</i>
Data:	<i>02.07.2019</i>
Vula:	

[në raste të kontratave me vlerë të lartë]

Për Konsulentin

Emri:	<i>Shpend Sopu</i>
Pozita:	<i>Direktor</i>
Nënshkrimi:	<i>[Signature]</i>
Data:	<i>02.07.2019</i>
Vula:	



SEKSIONI II I KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizimet

1.1 "**Kontratë**" do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Konsulentit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "**Shërbimet**" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Konsulentit siç është përshkruar në TER.

1.3 "**Konsulenti**" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "**Personeli**" do të thotë personat e angazhuar nga Konsulenti ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "**Çmimi i kontratës**" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "**Nënkontraktuesi**" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Konsulenti.

1.7 "**Palë**" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Konsulentin, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkuption të dy prej tyre.

1.8 "**Autoriteti Kontraktues**" nënkuption autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "**KPK**" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "**KVK**" nënkuption Kushtet e Veçanta të Kontratës.

1.11 "**Shpenzime të Kompenzueshme**" nënkuption të gjitha kostot e ndërlidhura me angazhimin përvëç kompensimit të Konsulentit.,

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Konsumenti e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Konsulenti nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvëç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Konsulentit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Konsulenti siguruesve të Konsulenti për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjeter i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Konsulentit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lironë Konsulentin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvëç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjeter financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Konsulenti ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertës. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontratës, Konsulenti duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Konsulentin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Konsulenti nuk nënkontrakton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Konsulenti është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Konsulentit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Konsulentin nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Konsulenti është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Konsulenti, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose ne një date tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Konsulenti do të fillojë shërbimet në datën e specifikuar në KVK, që do të përkufizohet si "Data Efektive".

6.3 Përveç nëse ndërpritet më herët sipas Nenit 9 dhe 10, kjo Kontratë do të skadojë në fund të periudhës së tillë kohorepas Datës Efektive të specifikuar në KVK.

6.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.5 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Forca madhore

7.1. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemite, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërvshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e njashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

7.2. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhëniet të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi, me kusht që Pala e ndikuar nga raste të tillë ka marrë parasysh të gjitha evitimet dhe kujdesin e mundshëm si dhe masat e mundshme alternative, të gjitha me qëllim të performimi të kushteve dhe termeve të kontratës.

7.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tanë e tutje me një vonesë minimale.

7.4. Një palë e afektuar nga një Forcë Madhore do të njoftoi Palën tjetër për një ngjarje të tillë sa më shpejt të jetë e mundshme, dhe në çdo rastë jo më vonë se katërmbrëdhjetë (14) ditë pas ndodhjes së një rasti të tillë, duke ofruar evidencë të natyrës dhe shkaktarëve të ngjarjes së tillë, dhe ngashëm do të njoftoi me shkrim pas restorimit të kushteve normale sa më shpejtë të jetë e mundshme.

7.5 Çdo periudhë kohore që nuk realizohen shërbimet si rezultat e ngjarjeve të Forcave Madhore, përfundimi i ndonjë aktiviteti apo detyre, do të zgjasë periudhën pér aq kohë sa ka ekzistuar gjendja e Forcës Madhore që ka pamundësuar Palës realizimin e aktiviteteve.

7.6 Gjatë periudhës së pamundësisë pér performimi e shërbimeve si rezultat e ngjarjeve të Forcave Madhore, Konsulenti, me udhëzim të Autoritetit Kontraktues, do të:

(i) demobilizohet, në ç'rast Konsulenti do të reimbursohet pér kosto shtesë të cilat i kanë shkaktuar arsyeshëm, dhe, nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktues, pér riaktivizimin e Shërbimeve; ose

(ii) do të vazhdoi me shërbime pér aq sa është e mundshme, në të cilin rast Konsulenti do të vazhdoi të paguhet nën kushtet e kësaj kontrate dhe të kompensohet pér kosto shtesë të shkaktuara arsyeshëm.

7.7 Në rastë të mospajtimit në mesë të Palëve pér ekzistencën apo rëndësinë e Forcës Madhore, çështja do të zgjidhet sipas Nenit 19.

Neni 8 Pezullimi

8.1 Autoriteti Kontraktues, me njoftim me shkrim të pezullimit të Konsulentit, mund të suspendoi të gjitha pagesat pér Konsulentin nëse Konsulenti dështon të kryej ndonjë nga obligimet e tij/saj nën këtë kontratë, përfshirë performimin e shërbimeve, me kusht që njoftimi i tillë pér pezullim (i) do të specifikojë natyrën e dështimit, dhe (ii) do të kërkojë konsulentit që të përmirësojë një dështim të tillë brenda periudhës jo më shumë se tridhjetë (30) ditë pas pranimit të njoftimit të tillë pér pezullim nga Konsulenti.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Konsulentit shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Konsulenti dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim pér të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Konsulenti refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Konsulenti ia jep dikujt kontratën apo nénkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Konsulenti falimenton ose është duke u myllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngashme e paraparë në legjislatacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Konsulenti është dënuar pér një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Konsulenti është shpallur fajtor pér sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Konsulenti i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* pér mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Konsulentit, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) Konsulenti dështon të respektojë ndonjë vendim përfundimtarë të arritur si rezultat i arbitrazhit të kryer në bazë të Nenit 19;
- (j) Si rezultat i Forcës Madhore, Konsulenti nuk është në gjendje që të kryej pjesë kryesore të Shërbimit pér një periudhë jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë;
- (k) Autoriteti Kontraktues, me vendim të tij dhe pér çfarëdo arsy, vendosë të ndërpref kontratën.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga ana e Konsulentit

10.1 Konsulenti, pasi e ka paralajmëruar me shkrim Autoritetin kontraktues 30 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Konsulentit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Konsulenti është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

c. nëse Autoriteti Kontraktues dështon të respektojë një vendim përfundimtarë të arritur përmes arbitrazhit sipas Nenit 19.

Neni 11 Ndërprerja e të drejtave dhe obligimeve me ndërprerje të kontratës

11.1 Me ndërprerje të kontratës sipas Nenit 6.5, Nenit 9 dhe 10, ose me skadimin e kësaj kontrate sipas Nenit 6.3, të gjitha të drejtat dhe obligimet e Palëve do të ndërketohen, përvç (i) të drejta të tillë dhe oblime që mund të janë akumuluar në ditën e ndërprerjes apo skadimit, (ii) obligimi i konfidencialitetit i parashtruar në Nenin 13.6 (iii) oblimi i Konsulentit për të lejuar inspektimin, kopimin dhe auditivin e llogarive të tyre apo të dhënave të caktuara në Nenin 13.8 dhe 13.9, dhe (iv) çdo e drejtë të cilën një Palë mudn të ketë nën Ligjin e Aplikueshëm.

11.2 me ndërprerje të kontratës me njoftim të cilësdo palë ndaj tjetërsipas nenit 9 dhe nenit 10, Konsulenti duhet, menjëherë pas dërgimit të njoftimit të tillë, të merr të gjitha hapat e nevojshtme për të sjellur shërbimet deri në përbillje në mënyrë të shpejtë dhe duhet të bëjë atë që është e mundur për të mbajtur shpenzimet për këtë qëllim në minimum. Në lidhje me dokumentet e përgatitur nga Konsulenti dhe pajisjet dhe materialet e furnizuara nga Autoriteti Kontraktues, Konsulenti do të vazhdojë siq është paraparë, respektivisht, me Nenin 13.12.

Neni 12 Pagesa pas Ndërprerjes

12.1 Me ndërprerje të kësaj kontrate sipas Nenit 9 dhe 10, Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesat në vijim për Konsulentin:

- Pagesa sipas nenit 16 për shërbimet e kryera me sukses para datës efektive të ndërprerjes; dhe
- Përvç në raste të ndërprerjes sipas pagagrafit (a) deri në (j) të Nenit 9, kompensimi i çdo kostoje të arsyeshme deri në ndërprerjen e kësaj Kontate përfshirë koston e udhëtimit të kthimit të Personelit dhe varësit e tyre të kualifikueshëm.

Neni 13 Obligimet e Konsulentit

13.1 Konsulenti do të kryejë Shërbimet dhe kryejnë detyrimet e tyre, me gjithë kujdesin e duhur, efikasitetit dhe ekonomisë, në përputhje me standarde t dhe praktikave të pranuara përgjithësisht profesionale, dhe do të respektojë praktikat e menaxhimit të shëndoshë, dhe të përdorin teknologji të përshtatshme dhe pajisjet, makineri, materialet dhe metodat e sigurta dhe efektive. Konsulenti duhet të veprojë gjithmonë, në lidhje me çdo çështje në lidhje me këtë Kontratë ose për shërbimet, si këshilltar besnik ndaj Autoriteti Kontraktues, dhe do të në çdo kohë duke mbështetur dhe mbrojtur interesat e ligjshme të Autoritetit Kontraktues në çdo marrëdhënie me Nën-Kontraktorët ose Palët e Tretë.

13.2 Konsulenti duhet të respektojnë dhe të respektojë gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, varësit e tyre, dhe punonjësit e tij të respektojnë të gjitha ligjet dhe rregulloret e tillë.

13.3 Konsulenti do të vendos interesat e Autoritetit Kontraktues si prioritet, pa ndonjë konsideratë për punën e ardhshme, dhe në mënyrë rigorozë duke shembang konfliktet me detyra të tjera ose interesat e tyre korporative.

13.4 Konsulenti pajtohet që, gjatë afatit të kësaj Kontrate dhe pas përfundimit të saj, Konsulenti dhe çdo subjekt lidhur me konsulentin, si dhe çdo Nën-Kontraktorë dhe çdo subjekt të lidhur me këta Nën-Kontraktorë, do të diskualifikohet nga furnizimi i mallrave, punime ose shërbime (me përashtim të shërbimeve të konsulencës), që rrjedhin nga ose janë të lidhur direkt me Shërbimet.

13.5 Konsulenti nuk do të angazhohet dhe do të shkaktojë që personeli i tyre si dhe nënkontraktorët e tyre dhe personelit të tyre të mos angazhohen, qoftë direkt ose indirekt, në aktivitetet e çdo biznesi apo aktivitete profesionale që do të bien ndesh me aktivitetet e caktuar sipas kësaj Kontrate.

13.6 Me përashtim me pëlqimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktues, Konsulenti dhe personeli nuk do të komunikojnë në asnjë kohë për asnjë person apo subjekt asnjë informacion konfidencial fituar në rrjedhën e Shërbimeve, po ashtu Konsulenti dhe Personeli nuk do të bëjë publike rekomandime të formuluara gjatë, apo si rezultat i Shërbimeve.

13.7 Konsulenti (i) do të marrë dhe të mbajë, dhe do të shkaktojë ndonjë Nën-Kontraktorët për të marrë dhe të mbajë nga kostoja e tyre (ose e 'Nën-Kontraktuesve, sipas rastit që mund të jetë), por në bazë të kushteve

të miratuara nga Autoriteti kontraktues, sigurim ndaj rreziqeve, si dhe për mbulimet e specifikuara në KVK, dhe (ii) me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofrojë dëshmi për autoritetin kontraktues që tregojnë se sigurimi i tillë është marrë dhe mirëmbahet dhe se premiumt t e tanishme për këtë janë paguar.

13.8 Konsulenti duhet të mbajë, dhe do të shkaktojë nën-kontraktorët e tij për të mbajtur, llogaritë të sakta dhe sistematike dhe të dhënat në lidhje me kontratën, në përputhje me parimet e kontabilitetit të pranuara ndërkombëtarisht dhe në atë formë dhe detaje që do të identifikojë qartë ndryshimet përkatëse të kohës dhe kostos

13.9 Konsulenti do të lejojë, dhe do të shkaktojë nën-kontraktorët e tij për të lejuar, autoriteti kontraktues për të inspektuar të gjitha llogaritë dhe të dhënat lidhur me zbatimin e kontratës dhe dorëzimit të propozimit për të ofruar shërbime, dhe të ketë llogaritë dhe registrat auditohen nga auditorë.

13.10 Konsulentët duhet të marrin miratimin e Autoriteteve Kontraktuese paraprakisht me shkrim para se të marrë ndonjë nga veprimet e mëposhtme:

- (a) Hyrja në një nënkontratë për kryerjen e ndonjë pjese të Shërbimeve,
- (b) emërimin e anëtarëve të tillë të personelit jo të listuara me emër në Shtojcën C ("Personeli kyç dhe nën-kontraktorët"), dhe
- (c) çdo veprim tjetër që mund të specifikohen në KVK.

13.11 Konsulenti do t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues raportet dhe dokumentet e specifikuara në shtojcën B, në formën, në numra dhe brenda afateve të përcaktuara në shtojcën e përmendur. Raportet përfundimtare do t'i dorëzohet në CD-ROM përvèç kopje të letrës të specifikuara në shtojcën e përmendur.

13.12 Të gjitha planet, vizatimet, specifikimet, projektimet, raportet, dokumentet tjera dhe softvere të përgatitura nga Konsulenti për autoritetin kontraktues në bazë të kësaj kontrate do të bëhen dhe mbeten pronë e autoritetit kontraktues, dhe Konsulenti duhet, jo më vonë se pas përfundimit apo skadimit të kësaj Kontrate, të dorëzojë të gjitha dokumentet e tillë për autoritetin kontraktues, së bashku me një inventar të detajuar të tij. Konsulenti mund të mbajë një kopje të dokumenteve të tillë dhe softver, dhe të përdorin softuer të tillë për përdorimin e tyre me miratimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktues. Në qoftë se marrëveshjet e licencës janë të nevojshme ose të përshtatshme në mes Konsulentit dhe palëve të treta për qëllime të zhvillimit të çdo programeve kompjuterike të tillë, Konsulenti duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim të autoritetit kontraktues për marrëveshje të tillë, dhe Autoriteti kontraktues ka të drejtë në diskrecionin e saj të kërkojë shpenzimet e lidhura me zhvillimin e programit (eve) përkatës. Kufizime të tjera për përdorim në të ardhmen e këtyre dokumenteve dhe softvereve, nëse ka, do të specifikohen në KVK.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Konsulenti do të punësojë dhe sigurojë personeli dhe nën-kontraktorët të kualifikuar dhe me përvojë që janë të nevojshëm për kryerjen e Shërbimeve.

14.2 Titullin, pëershkrimit i punës, kualifikimi minimal dhe periudha e parashikuar e angazhimit në kryerjen e Shërbimeve të secilit prej personelit kyç të Konsulentit janë pëershkuar në Shtojcën C. Nëse ndonjë nga personeli kryesor tashmë është miratuar nga autoriteti kontraktues, emri i tij / saj është i shënuar gjithashtu.

14.3 Personeli Kyç dhe nën-kontraktorët e shënuar nga titulli, si dhe me emër në Shtojcën C janë të miratuar nga Autoriteti Kontraktues. Në lidhje me Personel të tjerë të cilët Konsulenti propozon për të përdorur në kryerjen e Shërbimeve, Konsulenti do t'i dorëzojë të Autoriteti Kontraktues për shqyrtim dhe miratim një kopje të curriculum vitae të tyre (CV). Nëse Autoriteti Kontraktues nuk do të kundërshtojë me shkrim (duke deklaruar arsyet e kundërshtimit) brenda njëzet e një (21) ditë nga data e marrjes së CV të tillë, personeli i tillë do të konsiderohet se është miratuar nga Autoriteti Kontraktues.

14.5 Përvèç rasteve kur Autoriteti Kontraktues mund të bien dakord ndryshe, nuk ka ndryshime në personelin kryesor. Nëse, për ndonjë arsyë përtëj kontrollit të arsyeshëm të Konsulentit, bëhet e nevojshme për të zëvendësuar ndonjë nga personeli kryesor, Konsulentët do të sigurojnë si një zëvendësim një person me kualifikime ekuivalente ose më të mirë.

14.6 Nëse Autoriteti Kontraktues konstaton se ndonjë prej personelit kanë (i) kryer sjellje të rënda ose kanë qenë të akuzuar se ka kryer një vepër penale, ose (ii) kanë arsyë të janë të pakënaqur me punën e ndonjë prej personelit, atëherë konsulentët, me kërkesë me shkrim të Autoritetit Kontraktues duke specifikuar arsyet e tij, do të japë si një zëvendësim një person me kualifikime dhe përvojë të pranueshme për Autoritetin Kontraktues.

14.7 Konsulenti nuk do të ketë të drejtë për kostot shtesë që rrjedhin nga ose incidentale për heqjen dhe / ose zëvendësimin e personelit.

Neni 15 Obligimet e Autoritetit Kontraktues

15.1 Përveç nëse specifikohet në ndryshe në KVK, Autoriteti Kontraktues do të bëjë atë që është e mundur për të siguruar që Qeveria do të:

- (a) Siguron Konsulentin, Nën-Kontraktorët dhe personelin me leje të punës dhe dokumentet tjera të tilla që do të janë të nevojshme për të mundësuar, Konsulentin, Nën-Kontraktorët ose personelin për kryerjen e Shërbimeve.
- (b) Kujdeset për Personelin dhe, nëse është e përshtatshme, varësit e tyre të kualifikuar të pajisen menjëherë me të gjitha vizat për hyrje dalje të nevojshme, leje qëndrimi, leje këmbimit dhe të gjitha dokumentet tjera të nevojshme për qëndrimin e tyre në Republikën e Kosovës.
- (c) Lehtëson qarkullimin e shpejtë përmes doganës dhe çdo pasurie të nevojshme për shërbimet dhe përgjirat personale të personelit dhe vartësve të tyre.

15.2 Nëse pas datës së kësaj Kontrate, nuk ka ndonjë ndryshim në ligjin në fuqi në lidhje me taksat dhe detyrimet e cila rrit ose ul koston e shkaktuar nga Konsulenti në kryerjen e shërbimeve, pagesat për Konsulentin sipas kësaj kontrate nuk do të ndryshohen.

15.3 Autoriteti Kontraktues do të vëjë në dispozicion të Konsulentit dhe Personelit, për qellime të Shërbimeve dhe do të jetë i lirë nga çdo pagesë për shërbimet, objektet dhe pronat të përshkruara në shtojcën D në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar në shtojcën D.

15.4 Në rast se shërbime të tilla, objektet dhe pronat nuk do të vihen në dispozicion të Konsulentit siç janë të specifikuara në shtojcën D, Palët do të bien dakord mbi (i) ndonjë shtyrje kohe që mund të jetë e përshtatshme për t'u dhënë për Konsulentin për kryerjen e shërbimeve, (ii) mënyrën në të cilën Konsulenti duhet të prokurojë shërbime të tilla, objektet dhe pronën nga burimet e tjera, dhe (iii) pagesat shtesë, nëse ka, të bëhen për Konsulentin si rezultat i kësaj.

15.5 Në konsideratë të shërbimeve të kryera nga Konsulenti nën këtë kontratë, Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesat e Konsulentit të tilla dhe në atë mënyrë që është parashikuar në nenin 16 të kësaj kontrate.

15.6 Autoriteti Kontraktues do të vëjë në dispozicion të Konsulentit pa pagesë personel të tillë professional dhe homolog mbështetje, që do të emërohen nga Autoriteti Kontraktues me këshilla të Konsulentit, nëse është specifikuar në Shtojcën D.

15.7 Personeli profesional dhe homolog të mbështetjes do të punojnë nën drejtimin ekskluziv të Konsulentit. Nëse ndonjë anëtar i personelit homolog nuk e kryen në mënyrë adekuante ndonjë punë të caktuar për një anëtar të tillë nga Konsulenti që është në përputhje me pozitën që zë një anëtar të tillë, Konsulenti mund të kërkojë zëvendësimin e një anëtar të tillë, dhe Autoriteti kontraktues nuk do të refuzojë në mënyrë të paarsyeshme të veprojë sipas kërkësës së tillë.

Neni 16 Pagesa për Konsulentin

16.1 Pagesa totale që duhet paguar Konsulentin nuk duhet të tejkalojë çmimin e Kontratës dhe duhet të përfshijë kostot e stafit, Nën-kontraktuesit, kostot, printimin, komunikimin, udhëtimet, akomodimet, dhe të tjera të ngjashme, dhe të gjitha kostot tjera të shkaktuara nga konsulenti gjatë kryerjes së Shërbimeve të përshkruara në Propozimin Financiarë.

16.2 Çmimi total i kontratës është vendosur në KVK.

16.3 Pagesat do të bëhen në euro. Pagesat e Konsulentit do të bëhen sipas orarit të pagesës të përcaktuara në KVK dhe ndaj një fature. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, pagesa e parë do të bëhet ndaj dispozitatve nga Konsulentët të një garancie bankare për të njëjtën shumë, dhe do të jetë e vlefshme për periudhën e përcaktuar në KVK. Çdo pagesë tjetër do të bëhet pasi që kushtet e dhëna në KVK për pagesë të tillë janë plotësuar, dhe Konsulentët kanë paraqitur një faturë original dhe çdo informacion shtesë dokumentuese për Autoritetin Kontraktues që cakton shumën e duhur.

16.4 Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Konsulenti do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjit kërkësës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.5 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkësat thelbësore.

16.6 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Konsulentin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Konsulenti do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.7 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.5, Konsulenti mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.8 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i jasin të drejtë Konsulentit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 **Sigurimi i Ekzekutimit**

17.1 Konsulenti do të, jo më vonë se ditën e nënshkrimit të kontratës, ofroj për Autoritetin Kontraktues një garanci për ekzekutimin e plotë dhe të duhur të kontratës. Shuma e sigurimit të ekzekutimit është specifikuar në KVK. Garancia e ekzekutimit do të mbahet ndaj pagesës për Autoritetin Kontraktues për ndonjë humbje që rezulton nga dështimi i Konsulentit për të ekzekutuar obligimet kontraktuale plotësisht dhe në mënyrë të duhur.

17.2 Garancia do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas skadimit të Kontratës.

17.3 Garancia e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e caktuar në Seksionin IV të kësaj kontrate.

Neni 18 **Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

18.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekje për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

18.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpigen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 19 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

19.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- vendim nga gjyqi; ose
- kur palët pajtohen, një vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

19.2 Modeli i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve p.sh. gjykata ose arbitrazhi do të vendoset nga palët para nënshkrimit të kontratës

Neni 20 **Dëmshpërblimi**

20.1 Konsulenti do të mbrojë dhe dëmshpërbuje Autoritetin Kontraktues dhe zyrtarët e saj aktual dhe ish-drejtoret, punonjësit, dhe agjentët dhe të ruaj ata nga dëmet dhe kundër çdo kosto, humbjet, dëmtimet, dhe jobat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar në tarifat e avokatëve dhe shpenzimet në lidhje me ndonjë: neglizhencë ose keqpërdorime të qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkelje ose shkelje të pretenduar të përfaqësive të Konsulentit, ankesë nga një palë e tretë që ofrimin e këtyre shërbimeve nga Konsulenti ose shfrytëzim nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues ose të aseteve të përdorura ose të siguruar nga Konsulenti në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësissë intelektuale të asaj pale të tretë.

SEKSIONI III I KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	i 2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Kjo kontratë do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga dy palët.
	6.3	Data e Skadimit të Kontratës është <i>90 dite pas nënshkrimit</i>
	6.4	Vendi i kryerjes së shërbimeve është <i>Prishtine</i>
Obligimet e Konsulentit	13.7	Rreziqet dhe mbulim minimal do të jetë si më poshtë: a) sigurimi i përgjegjësisë të punëdhënësit dhe të kompensimit të punëtorëve në lidhje me Personelin e Konsulentit dhe të çdo Nën-Kontraktorëve, në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit në fuqi, si dhe, në lidhje me një personel të tillë, çdo sigurim i tillë, jetësorë, shëndetsorë, aksidentalë, udhëtimit ose të sigurimit tjetër siç mund të jetë e përshtatshme, dhe b) sigurimi kundër humbjes ose dëmtimit të (i) pajisjeve të blera në tërësi ose pjesërisht me fonde të siguruara sipas kësaj Kontrate, (ii) pasurinë e konsulentit të përdorura në kryerjen e shërbimeve, dhe (iii) çdo dokument të përgatitur nga Konsulenti në kryerjen e shërbimeve.
	13.10 (c)	N/A
	13.12	N/A
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	15.1	N/A
Pagesat për Konsulentin	16.2	Çmimi total i kontratës është 24.970,00 € . Pagesat bëhen në tri situacione. Në situacionin e parë dhe të dytë pagesat bëhen në vlera prej 8.000,00 € ndërsa në situacionin e tretë dhe të fundit pagesa bëhet në vlerën e jo më pak se 10% e vlerës së përgjithshme të kontratës.
	16.3	Nuk do të ketë pagesë në avans. Pagesat për dorëzime do të bëhen sipas orarit në vijim:
Siguria e ekzekutimit	17.1	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës totale te kontratës me vlerë prej: 2.497,00 €, me validitet prej 120 dite
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	18.2	<i>Komisioni per ndermjësim pranë Ministritë se Drejtisë</i>

Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	19.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përherëshëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.</p>
---	------	--

TERMAT E REFERENCËS PËR MBËSHTETJE TEKNIKE PËR HARTIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PEIZAZHIT TË MBROJTUR “GËRMIA”

Një prej pasurive më të rëndësishme të Komunës së Prishtinës është peizazhi i mbrojtur “Gërmia”. Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë ofron kushte të mira për një sërë speciesh. Kuvendi Komunal i Prishtinës e ka marrë në mbrojtje parkun e Gërmisë, si një park natyral. Me këtë vendim të dikurshëm, zona mbrohej në sipërfaqen prej 1,126 hektarë. Parku menaxhohet nga NPL “Hortikultura” Sh.A kurse monitorimi profesional është bërë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Për shkak te bukurive, vlerave burimore edhe estetitko-natyrore, kësaj zone i është kushtuar rëndësi qysh herët. Territori i Gërmisë me vendimin nr 01-12035 të datës 31 Maj 1966 (GZK nr.32/66) është përcaktuar si zonë me destinim të veçantë “pyje dhe piknik” për të krijuar kushte të favorshme për pushim dhe zhvillim të turizmit duke përfshirë pjesën e maleve në krahun e djathtë të ligenit të Badocit (malert nga zonat kadastrale si Katund i RI, Zllatar, Hajvali, Mramor dhe Komunën e Graçanicës). Në planin Hapësinor të Kosovës të vitit 1980-2000 territori i Gërmisë në kuptim të gjërë me ligenin e Badocit është paraparë si vend i përshtatshëm për pushim dhe vikend. Në bazë të vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01.330-659 të datës 29.12.2005 dhe statutit të Ndërmarrjes Publike Komunale “Hortikultura” në Prishtinë të aprovuar nga KK-Prishtinë nr. 110-267 të datës 30.05.2006, autorizimi për mirëmbajtje i ka kaluar ndërmarrjes në fjalë. Kuvendi i Komunës së Prishtinës në mbledhjen e mbajtur me datë 21.12.2016 miratoi vendimin për ri kategorizimin e parkut rajonal natyrore “Gërmia” në kategorinë – peizazh i mbrojtur me ç'rast territori i parkut u zgjerua në 1,949 hektarë. Gërmia sipas IUCN-it i takon kategorisë së V-të të mbrojtjes e cila synon menaxhim të kujdeshshëm në ruajtjen dhe mirëmbajtjen e ekosistemeve dhe peizazheve. Në vitin 2015, një komision profesional i ka paraprirë shpalljes së Gërmisë peizazh i mbrojtur përmes një dokumenti me të dhëna mbi karakteristikat fiziko-gjeografike, florën e

vegjetacionin dhe veçoritë e faunës, punuar në bazë të vendimit Nr. 1317/14 të datës 18.03 2014 të nxjerrë nga Kryeshefi ekzekutiv i AMMK-së.

1. Qëllimi i hartimit të Planit të Menaxhimit

Plani i Menaxhimit të zonave të kategorizuara si ‘peizazhe të mbrojtura’ përcakton kahet e zhvillimit, mënyrën e mbrojtjes, shfrytëzimit dhe menaxhimit me zonën e mbrojtur dhe kahet më të përafërtë për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave të natyrës në zonën e mbrojtur duke pas në konsideratë nevojat e komunitetit lokal. Ky plan ka për qëllim që të përcaktojë mbrojtjen e zonës duke definuar aktivitetet e lejuara, ato të ndaluara dhe autoritetet përgjegjëse për vendimmarrje. Në bazë të nenit 75 të Ligjit për mbrojtjen e Mjedisit, aktivitetet të cilat ndalojen të kryhen janë; dëmtimi dhe/ose shkatërrimi i shenjës dhe/ose tabelës informuese; ndezja e zjarrit jashtë vendeve që për ketë qellim janë të shënuara; xhirimi ose fotografimi për qëllime komerciale pa lejen e organit kompetent të komunës; fluturimi me fluturake ultra të lehtë pa lejen e organit kompetent të komunës; vendosja e pllakave informative, panove reklamuese ose tjera pa lejen e organit kompetent të komunës; vizita dhe/ose shikimi pa biletë kur ajo është e detyruar; hedhja e mbeturinave jashtë vendit të paraparë për këtë. Me qëllim të menaxhimit më efektiv të zonës së shpallur ‘peizazh i mbrojtur’, Plani i menaxhimit ka për qëllim të definojë edhe regjimet e mbrojtjes sipas zonave:

Zonat e para (që janë vendbanime ose vendndodhje e ndonjë lloji të rrallë apo të rezikuar të florës dhe faunës);

Zonat e dyta (zona ku lejohen intervenime të kufizuara dhe kontrolluara) dhe

Zonat e treta (ku lejohen edhe ndërhyrjet si ndërtim dhe rindërtim), por gjithnjë duke pasur kujdes që mos të shkatërrohen karakteristikat themelore për të cilat PM është shpallur nën mbrojtje.

2. Parimet e Planit të Menaxhimit dhe baza ligjore

Baza ligjore e Planit të Menaxhimit për peizazhin e mbrojtur "Gërmia" derivon nga dy ligje,

Plani Hapësinor i Kosovës dhe vendimi i Kuvendit Komunal të Komunës së Prishtinës

- Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrotjen e Natyrës GZRK Nr. 85/09 Nëntor 2010;
- Ligji Nr. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR
- V E N D I M I PËR RIKATEGORIZIMIN E PARKUT RAJONAL NATYROR "GËRMIA" NË KATEGORINË – PEIZAZH I MBROJTUR, dt.22.12.2016
- PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS: STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 2010-2020+

Sipas nenit 5 të Ligjit për Mbrotjen e Natyrës, parimet që duhen respektuar janë:

1.1 Parimi i përkujdesjes – kur bazuar në rjohuritë shkencore dhe tekniko-teknologjike konstatohet se një aktivitet i veçantë ose veprim mund të dëmtoj natyrën, masat dhe aktivitetet e domosdoshme duhet të ndërmerren përpara se dëmet mund të ndodhin.

1.2. Parimi i integrimit – masat dhe aktivitetet për mbrotjen e natyrës duhet të integrohen në të gjitha planet zhvillimore strategjike, dokumentet dhe programet e planifikimit hapësinor, planet zhvillimore hapësinore si dhe planet për menaxhimin dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës.

1.3. Parimi shfrytëzuesi paguan – kur shfrytëzon natyrën shfrytëzuesi është i detyruar që të paguaj për lartësinë e shpenzimeve të mirëmbajtjes së baraspeshës natyrore dhe shfrytëzimin e trashëgimisë natyrore si dhe të sanoj dëmtimin e natyrës që ka ndodhur gjatë shfrytëzimit të natyrës dhe trashëgimisë natyrore.

1.4. Parimi i proporcionalitetit - të mirat natyrore të papërtëritshme duhet shfrytëzuar në mënyrë rationale, ndërsa ato të ripërtëritshme në mënyrë të qëndrueshme.

1.5. Parimi i pjesëmarrjes së publikut - publiku ka të drejtë për qasje në informatat për gjendjen e natyrës, të drejtë në informimin me kohë për dëmet në natyrë, masat e ndërmarra për eliminimin e dëmeve të shkaktuara si dhe të drejtën dhe mundësinë e pjesëmarrjes në vendim marrje për natyrën.

1.6. Parimi i përgjegjësisë subsidiare - në rastet kur përgjegjësia për dëmin nuk dihet atëherë përballimin e kostos së rehabilitimit dhe zvogëlimit dëmit në natyrë e bartin institucionet shtetërore.

1.7. Parimi i parandalimit – është e drejtë dhe detyrim i çdo personi juridik a fizik që të ndërmerr masat dhe aktivitetet për mbrojtjen e natyrës përpara se dëmi të ndodh.

1.8. Parimi i bashkëpunimit - në shfrytëzimin e të mirave të natyrës dhe planifikimin e hapësirës personat juridik dhe fizik detyrohen t'u përbahen parimeve, masave dhe kushteve të mbrojtjes së natyrës

3. Përbajtja e Planit të Menaxhimit të peizazheve të mbrojtura

Sipas Nenit 82 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës mbi përbajtjen e Planit të Menaxhimit për zonën e mbrojtur PM duhet të përfshijë: .

1.1. qëllimet dhe politikën e menaxhimit të zonës së mbrojtur me përbërësit:

1.1.1. vizionin, misionin dhe qëllimet e zonës së mbrojtur;

1.1.2. politikën e menaxhimit me zonën e mbrojtur.

1.2. kahet e mbrojtjes të zonës së mbrojtur, me përbërësit:

1.2.1. vlerësimi i gjendjes të zonës të mbrojtur dhe të ndikuar;

1.2.2. koncepti i mbrojtjes i tërë zonës dhe pjesëve të caktuara të saj;

- 1.2.3. përcjellja e gjendjes të zonës të mbrojtura dhe vlerave të saj;
- 1.2.4. mbrojtja dhe menaxhimi i vlerave të natyrës dhe të kulturës si dhe të mirave të natyrës në zonën e mbrojtur;
- 1.2.5. zhvillimi veprimtarive të lejuara në zonën e mbrojtur;
- 1.2.6. vizita në zonën e mbrojtur - programi i vizitave, interpretimit;
- 1.2.7. lidhja e zonës së mbrojtur me zonat në fqinjësi;
- 1.2.8. ndikim në mjedis dhe kompleksi ekonomiko-shaqëror.

1.3. zbatimi i planit me përbërësit:

- 1.3.1. kahet për lidhjet me planet sektoriale;
- 1.3.2. aktivitetet për zbatimin planeve; 1.3.3. mbikëqyrjen për zbatimin e planit;
- 1.3.4. shpenzimet për zbatimin e planit;
- 1.3.5. mënyrat dhe burimet e financimit të planit;
- 1.3.6. struktura institucionale dhe bartësit e aktiviteteve në menaxhimin e zonës së mbrojtur.

Sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, neni 85, pika 5, Plani i Menaxhimit hartohet në kohëzgjatje prej dhjetë (10) vjetësh dhe pas kalimit të periudhës prej pesë (5) vjetësh, bëhet analiza e zbatimit të planit të menaxhimit dhe rezultatet e arritura dhe sipas nevojës bëhet revidimi i planit të menaxhimit sipas mënyrës dhe procedurës të përcaktuar për nxjerrjen e tij.

Drejtoria e Parqeve përmes procedurave të tenderimit do të angazhojë për mbështetje teknike një kompani të jashtme. Kjo kompani konsulentë do të mbështesë Komunën e Prishtinës në aspektin teknik, sipas detyrave të përcaktuara më poshtë:

Organizimi i 5-6 punëtorive (rezervimi i hapësirës me një drekë pune të përfshire) me grupet punuese të caktuara, në bazë të kërkesës së Drejtorisë së Parqeve;

Grumbullimi dhe sistemimi i materialeve tekstuale dhe grafike nga grupi/et punuese në bazë të detyrave të përcaktuara për secilin grup punues;

Printimi, kopjimi dhe përgatitja e materialeve për të gjitha fazat, si gjatë takimeve të grupit punues, komitetin konsultativ dhe grupet e tjera të interesit;

Mbajtja e procesverbaleve gjatë secilit takim qoftë me grupe punuese apo i grupit në tërësi (audio incizim dhe transkript të shkruar) dhe përcjellja e procesverbalit paraprak për miratim tek anëtarët;

Lektorim dhe përkthim i dokumentit përfundimtar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze;

Formati, përbajtja dhe përpjesa e paraqitjes së të gjitha të dhënave dhe pjesëve hartografike me Udhëzim Administrativ për databazën e Planifikimit Hapësinor (Neni 5, pika 6, UA nr. 11/2015);

Të gjitha hartat hapësinore konceptuale, hartat ilustrative të prezantohen mbi harta të gjeo-referencuara ortografike dhe topografike (Neni 5, pika 7 UA nr. 11/2015);

Të gjitha të dhënat bazë dhe të dhënat në GIS bëhen pronë e Komunës (Neni 5, pika 8 UA nr. 11/2015);

Organizimi i shqyrtimit publik – mbështetje Komunës për shqyrtimin publik sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, në të cilin proces duhet të jenë prezent ekspertët e kompanisë së kontraktuar;

DORËZIMI I PLANIT

Dokumenti i Planit të Menaxhimit të peizazhit të mbrojtur “Gërmia” duhet të dorëzohet në:

5 kopje (3 në gjuhën shqipe, 1 në serbe dhe 1 në gjuhë angleze) të shtypura në lidhja të fortë (palosja në format A4);

2 kopje të pjesës grafike të Planit të Menaxhimit të shtypura në formatin A0/A1;

Formati digjital, GIS, Shapefile, autocad dhe PDF;

Kapaciteti teknik dhe profesional i Kompanisë :

1. Lista e projekteve për shërbime të ngjashme (2013-2018)

2. Lista e stafit profesional:

1 planer;

1 inxhinier i pylltarisë;

1 gjeodet i licensuar;

1 ekspert i turizmit

1 ekspert i GIS-it

1 ekspert i licensuar i vlerësimit të ndikimit në mjedis;

Varësisht nga nevojat gjatë procesit mund të shtohen ekspert ose mjete